



E nderuara znj Olmstead,

I nderuari ambasador Rohde,

I nderuari z. Berisha,

Është kënaqësi e veçantë të jem pjesë e kësaj ceremonie që shënon një hap shumë të rëndësishëm në lansimin e Dritares së Mundësive të Rimëkëmbjes së Gjelbër, ku përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, do të lehtësohet qasja në financa për bizneset që investojnë në Energjinë e Ripërtëritshme edhe në Efiçencën e Energjisë. Lansimi i këtij projekti të hartuar dhe financuar nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit dhe Fondacionit të Mijëvjeçarit në Kosovë, dhe me kapitalin e dhuruar nga KFW tregon përkrahjen e vazhdueshme të miqve tanë ndërkombëtarë për zhvillimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe në përgjithësi për zhvillimin e ekonomisë së Kosovës.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore ka arritur të shndërrohet në një institucion shumë të rëndësishëm për rritjen e lehtësimit të financimit për ekonominë e vendit.

Institucionet financiare luajnë një rol shumë të rëndësishëm në financimin e ekonomisë së gjelbër, andaj ky projekt do të ndihmoj dukshëm promovimin dhe nxitjen e mëtejme të tranzicionit të gjelbër.

Ky projekt gjithashtu do të mundësojë rritjen e potencialit garantues të këtij institucioni, duke bërë të mundur rritjen e numrit të përfituesve nga garancionet që lëshon ky institucion. Me fjalë të tjera, një numër mjaft i madh i bizneseve me vështirësi në qasjen në financa, do të mund të sigurojnë qasje me kushte lehtësuese në këtë burim të financimit.

Kreditimi bankar vazhdon të jetë një burim shumë i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i financimit të sektorit privat në Kosovë. Vlera e kredive bankare me të dhënat e Prillit 2022 ka arritur në 4 miliard euro, apo me një rritje vjetore prej 17.9%. Sidoqoftë, me gjithë trendin e kënaqshëm të rritjes së kreditimit bankar, konsiderohet se shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë vazhdon të jetë nën mesataren e vendeve të rajonit, gjë që tregon për mundësinë që kjo dritare dhe FKGK-ja është duke dhënë që të rritet shkalla e ndërmjetësimit financiar në Kosovë.

Rol të rëndësishëm ka edhe hapja e kësaj dritare. Në këtë kontekst, ne presim që përveç mbështetjes së rritjes së financimit kreditor në përgjithësi, portfolio e FKGK-së çdo ditë e më tepër të reflektojë rritjen e mbështetjes kreditore për sektorët me vështirësi më të madhe të qasjes në financim kreditor, por të cilët kanë potencial për të dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit.

Për këtë arsye, hapja e kësaj dritare dhe shumë dritare të tjera në kuadër të FKGK-së, kanë të bëjnë me faktin që kemi nevojë që të përkrahim bizneset, të cilat kanë vështirësi në qasje në financa. Ne sot nëse e shohim strukturën e ekonomisë së vendit në Kosovë, kemi një strukturë të ekonomisë që kryesisht dominohet prej ndërmarrjeve tregtare. Dhe ideja është që përmes këtyre programeve, përmes këtyre projekteve, përmes këtyre dritareve, që të ndërrojmë strukturën e ekonomisë në vend. Me qëllim që të kemi sa më shumë ndërmarrje prodhuese. Në

këtë mënyrë besoj që Kosova do t'i adresonte dy sfidat që në vazhdimësi i ka pas dhe që është papunësia dhe deficitit i lartë tregtar. Për fund ju faleminderit shumë, ju uroj punë të mbarë, shëndet dhe suksese.